




Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës
Opština Podujeva / Municipality of Podujeva



Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezi

RAPORT VJETOR I PUNËS – JANAR-DHJETOR 2024

DATË/A:	16.12.2024
PËR:	Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës
NGA:	Saranda Stublla, Drejtor <i>[Signature]</i>
TEMA:	Raport mujor i punës: Janar - Dhjetor 2024
Nr.Pro:	08-401/04-0079285/24



Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës:

Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, konkretisht Zyra Kadastrale Komunale (ZKK) e Podujevës, ka vazhduar të ofrojë shërbime efikase dhe të standardeve të larta për qytetarët. Ajo ka siguruar informacione dhe të dhëna të azhurnuara për pronat e paluajtshme, duke mbajtur transparencën dhe efikasitetin në çdo proces.

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2024, pranë sektorit për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi janë pranuar gjithsej 9,391 kërkesa të ndryshme për shërbime kadastrale. Nga këto kërkesa, 407 janë refuzuar, 233 janë ende në procedurë, ndërsa 8,751 kërkesa janë aprovuar. Kjo do të thotë se 93,2% e të gjitha kërkesave të pranuar janë përfunduar dhe kanë marrë përgjigje pozitive, duke dëshmuar angazhimin për ofrimin e shërbimeve të cilësisë së lartë dhe efikasitetit në trajtimin e kërkesave të qytetarëve.

Raporti i Aktivitetit për Regjistrimin e Pronës dhe Shërbimet e Ofruara

- Gjatë vitit 2024, janë trajtuar dhe shqyrtuar një numër të konsiderueshëm kërkesash për regjistrimin e pronës dhe shërbime të lidhura, duke siguruar një nivel të lartë efikasiteti dhe përgjegjshmërie në përpunimin e tyre. Disa nga rezultatet kryesore janë si vijon:
- **1,753** kërkesa për regjistrimin e bartjes së pronësisë, të cilat përfshijnë aktvendime mbi shqyrtimin e trashëgimisë, kontrata shitblerjeje apo dhurimi të paluajtshmërive, aktgjykime etj. Nga këto, janë aprovuar **1,621** kërkesa, **125** janë ende në procedurë dhe **7** janë refuzuar. Kjo i përgjigjet një shkalle aprovimi prej **92,5%**, me **7,1%** të kërkesave në procedurë dhe **0,4%** të refuzuara.
- **670** kërkesa për ndarje, bashkim, përcaktim, legalizim dhe ri-rregullim të njësive kadastrale janë shqyrtuar, ku janë aprovuar **529** kërkesa, janë pezulluar **26**, janë refuzuar **6**, dhe **109** kërkesa janë ende në procedurë. Në përqindje, **79%** e kërkesave janë aprovuar, **3,8%** janë pezulluar dhe **17,2%** janë në procedurë.
- **28** kërkesa për historikë pronësie nga persona fizikë dhe juridikë janë të gjitha aprovuar.

- 168 kërkesa për regjistrimin e hipotekave dhe çregjistrimin e hipotekës janë shqyrtuar dhe të gjitha janë aprovuar.
- 482 kërkesa për korigjimin e të dhënave personale në certifikatën e pronësisë janë përpunuar, dhe të gjitha janë aprovuar.
- 7 kërkesa për shënimin e urdhërit përmbartimor janë trajtuar dhe të gjitha janë aprovuar.
- 6 kërkesa për shënimin e Masës së Përkohshme të Sigurisë nga GJTHP janë shqyrtuar dhe të gjitha janë aprovuar.
- 1 kërkesë për lirim të barrës tatimore është trajtuar dhe është aprovuar.
- 6,276 kërkesa për certifikata pronësie, kopje të planit, koordinata për njësi, vërtetim që pala nuk posedon paluajtshmëri dhe të tjera janë shqyrtuar. Nga këto, 5,886 kërkesa janë aprovuar, dhe 390 kërkesa janë anuluar, duke arritur një shkallë aprovimi prej 93,8%, ndërsa 6,2% janë anuluar.

Aktivitetet të Implementuara në Sektorin për Pronë

Gjatë vitit 2024, pranë Sektorit për Pronë janë pranuar gjithsej 10 kërkesa për shndërrimin e pronës nga private në pronë shoqërore, me destinacion rrugë publike, duke kontribuar në zhvillimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët.

Në përputhje me detyrat e caktuara zyrtare, pranë këtij sektori janë realizuar shërbime të ndryshme, përfshirë:

- 40 propozim-vendime për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunes.
- 53 njoftime për shfrytëzuesit e pronës komunale.
- 47 ftesa për takime informuese me shfrytëzuesit e pronës së Komunes, për të siguruar transparencë dhe ndërgjegjësim në lidhje me proceset dhe rregulloret e pronësisë.
- 3 procedura të uzurpimeve, që kanë pasuar procedurat ligjore për të siguruar mbrojtjen e interesave të Komunes dhe të qytetarëve.

Përfundim

Sektori për Kadastër dhe Gjeodezi ka realizuar një vit të suksesshëm, duke trajtuar një numër të konsiderueshëm kërkesash dhe duke ofruar shërbime të cilësisë së lartë për qytetarët. Angazhimi për transparencë, efikasitetin dhe saktësinë në administrimin e pronave ka sjellë rezultate pozitive, duke përmirësuar përvojën e qytetarëve dhe duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të Komunes.

Me nderime!